



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 713/1 Prot.

Tiranë, më 13. 05. 2019

V E N D I M

Nr. 61, Datë 13. 05. 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 193 rregj., datë 18.12.2018, të shtetasit D. E., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (në vijim DPB) dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë (në vijim IEVP), me pretendimin diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore dhe aftësisë së kufizuar¹*”,

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi D. E., shpjegon se është punonjës i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, prej muajit Janar 2011. Në vitin 1989, është diplomuar në degën “Financë për industri” dhe ka një eksperiencë 26 vjeçare në pozicione të ndryshme pune. Gjatë periudhës së punës në IEVP Vlorë, është transferuar në pozicione të ndryshme pune. Fillimisht me Urdhërin Nr. 4518/1, datë 19.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, është vendosur transferimi i ankuesit nga pozicioni i Specialistit të Financës, në pozicionin e Specialistit të Edukimit në Sektorin e Çështjeve Shoqërore në IEVP Vlorë. Lidhur me transferimin në këtë pozicion pune, ankuesi i është drejtuar me shkresë zyrtare Drejtorit të IEVP-së Vlorë, duke kundërshtuar emërimin në këtë pozicion, jashtë kriterëve arsimore, pasi ky pozicion pune kërkonte arsimim si punonjës social. Pavarësisht faktit që ankuesi ka kundërshtuar emërimin në këtë detyrë, ka mbajtur këtë pozicion pune deri më datë 04.11.2016, kur është transferuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në pozicionin e Kartelistit, në Sektorin Juridik të IEVP-së Vlorë.

Gjatë vitit 2016, IEVP Vlorë, i është nënshtruar një auditimi nga ana e Njësisë së Auditimit të Burgjeve, ku ndër të tjera është konstatuar emërimi jashtë kriterëve arsimore të dy punonjësve, D. E. dhe specialistes së financës, O. M. Në përfundim, Njësia e Auditit kishte

¹ Mbështetur në Dëshminë e Invaliditetit Nr. 384, ankuesi vërteton faktin se është invalid i pjesshëm.

rekomanduar emërimin e ankuesit në pozicionin e specialistit të financës, pasi në këtë pozicion ishte emëruar jashtë kriterëve një punonjëse me arsim të lartë “Menaxhere Turizmi”.

Edhe pse Njësia e Auditit të Burgjeve kishte rekomanduar emërimin e ankuesit në pozicionin e specialistit të financës, ai është transferuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në pozicionin e kartelistit, në Sektorin Juridik të IEVP-së Vlorë, me pagë më të ulët dhe pozicion në të cilin kërkohet arsimi i mesëm.

Ankuesi me shkresën datë 21.06.2018, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, duke e vënë në dijeni lidhur me transferimet e tij nga njëri pozicion në tjetrin dhe pasojat që kanë ardhur si rezultat i këtyre lëvizjeve, si dhe ka kërkuar që të merren masa për rikthimin e tij në detyrën e specialistit të financës. Pavarësisht kërkesës së sipërcituar, ankuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Në përfundim, ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe diskriminuese për shkak të gjendjes arsimore dhe aftësisë së kufizuar, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke u transferuar dhe emëruar në pozicione pune me pagë më të ulët dhe të papërshtatshme me arsimin që disponon. Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese dhe të marrë të gjitha masat për rikthimin e tij në pozicionin e financierit të IEVP-së Vlorë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 193, datë 18.12.2018 të D. E. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me anë të shkresës³ Nr. 1746/1 prot., datë 21.12.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-së Vlorë, ku i ka kërkuar informacion⁴ dhe parashtrime rreth ankesës së paraqitur nga ana e D. E.
- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me anë të shkresës Nr. 12662/1 prot., datë 08.01.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (në vijim DPB), ka vënë në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi një pjesë të informacionit të kërkuar nga KMD. Gjithashtu në shkresën e sipërcituar Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ndër të tjera ka sqaruar se, Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë kontrollit të kryer në IEVP Vlorë është shprehur se: *“U konstatua që 2 punonjës civilë të jenë caktuar në pozicione pune jashtë kritereve arsimore, znj. O. M. me arsim të lartë menaxhere turizmi në pozicionin specialiste finance dhe punonjësi D. E., i arsimuar për ekonomi financë në pozicionin specialist në sektorin e çështjeve sociale. Këshillohet që kjo situatë ti bëhet e ditur Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve”*. Në vijim të shkresës DPB ka sqaruar se, në IEVP Vlorë në pozicionin e punës specialist buxheti është e emëruar N. B., e cila ka arsimin e lartë në Financë, ndërsa në pozicionin e punës specialist Finance është emëruar V. Ç., e cila po ashtu ka përfunduar arsimin e lartë Financë. Në IEVP Vlorë është edhe një punonjëse tjetër e cila ka përfunduar studimet për Financë dhe aktualisht është e emëruar në pozicionin sekretar protokollist. Në përfundim të arsyetimit, DPB ka sqaruar se emërimi në detyrën aktuale të D. E. nuk ishte bërë për shkak të gjendjes së tij arsimore dhe aftësisë së kufizuar, por për shkak të përshtatshmërisë së arsimimit me pozicionin e punës.
- Nga IEVP Vlorë, me anë të shkresës⁵ Nr. 13 prot., datë 10.01.2019, është sqaruar se: *“D. E. është punësuar pranë IEVP Vlorë, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve me datë 18.01.2011, nr. 332/2 prot. dhe është emëruar në detyrën Kartelist, në Sektorin*

³ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 61, datë 14.01.2019

- ⁴ Informacion mbi pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e shtetasit D. E.
- Informacion dhe kopje të Raportit të Njesisë së Auditit të Burgjeve të vitit 2016 (vetëm faqet ku rekomandohet rikthimi i D. E. në pozicionin e financierit).
- Informacion nëse është kryer ndonjë proces auditimi pas vitit 2016. Nëse po kopje të tij.
- Informacion dhe kopje të dosjes personale, të punonjësit të emëruar në pozicionin specialist finance në IEVP Vlorë.

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 66, datë 14.01.2019

Ligjor. Me urdhër të DPB-së, datë 01.03.2013, nr. 1563/1, pas daljes në pension të punonjëses së mëparshme, D. E. është transferuar nga pozicioni Kartelistit, në pozicionin e Specialistit të Financës me motivacionin vend vakant, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më datë 19.05.2015. Duke marrë parasysh punën me orar të reduktuar për shkak të raportit të invalidit të D. E., me urdhër të DPB-së nr. 4516/1, datë 19.05.2015, ai është transferuar në pozicionin e Specialistit të Edukimit në Sektorin e Çështjeve Shoqërore për shkak të mbingarkesës së Sektorit të Financës. Këtë detyrë e ka ushtruar deri më datën 26.10.2016, ku me urdhër të DPB-së nr. 8465, D. E. është transferuar në pozicionin Kartelist në Sektorin Ligjor, duke marrë parasysh orarin e reduktuar të punës që kryen, si dhe duke zbatuar kriteret përkatëse të përshtatjes së arsimit të përfunduar me detyrën funksionale që kryen ç' do punonjës në institucion. Raporti përfundimtar i Auditit të vitit 2016, ka këshilluar që kjo situatë t'i bëhet e ditur DPB-së. Të gjitha këto lëvizje të D. E., janë kryer për shkak të ngarkesës voluminoze të punës që kanë Sektorët e Edukimit dhe veçanërisht Sektori i Financës, si dhe orarin e reduktuar të punës së D. E., për shkak të statusit të invalidit , ku një pjesë e të ardhurave mbulohet nga Sigurimet Shoqërore. Duhet theksuar se në Strukturën organike të miratuar nga Kryeministri nuk ka mundësi shtimi të pozicioneve të punës, prandaj nga drejtuesit janë menduar lëvizjet e sipërpërmendura, duke pasur parasysh edhe urdhërin fillestar të emërimit si Kartelist, pranë Sektorit Ligjor të IEVP-së Vlorë. Këto lëvizje janë kryer jo për të diskriminuar D. E., por për ti krijuar mundësi dhe kushte më të mira pune, si dhe nga ana tjetër mbarëvajtjen e punës në institucion. Përsa më sipër, është e pamundur që D. E. të kthehet në pozicionin e Specialistit të Financës, pasi Sektori i Financës, për shkak të volumit të punës kërkon një punonjës me kohë të plotë dhe jo me kohë të pjesshme. Punonjësja që sot ushtron këtë funksion, është diplomuar në degën Ekonomi-Financë, në Universitetin e Vlorës.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 193, datë 18.12.2018, Komisioneri me shkresën nr. 251 prot., datë 14.02.2019, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 20.02.2019 duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
 - Informacion mbi pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e shtetasit D. E.
 - Informacion dhe kopje të Raportit të Njësisë së Auditit të Burgjeve të vitit 2016 (vetëm faqet ku rekomandohet rikthimi i D. E. në pozicionin e financierit).
 - Informacion nëse është kryer ndonjë proces auditimi pas vitit 2016. Nëse po kopje të tij.
 - Informacion dhe kopje të dosjes personale, të punonjësit të emëruar në pozicionin specialist finance në IEVP Vlorë.

Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve në proces: subjektit ankues dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, B. P.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Ankuesi, pasi u njoh me pretendimet e përcjella me shkresën Nr. 13 prot., datë 10.01.2019, nga ana e I EVP Vlorë, sqaroi se nga ana e drejtuesve të institucionit nuk është bërë më dije ndonjë herë se fakti që ai punon me orar të reduktuar për shkak të aftësisë së kufizuar (6 orë/ditë) dhe ngarkesa në Sektorin e Edukimit dhe atë të Financës, ka bërë që ai të transferohet në pozicionin e Kartelistit. Gjithashtu, ankuesi parashtrori se pretendimet për diskriminim, lidhen me faktin e emërimit në pozicionin e Kartelistit, për shkak se ky pozicion kërkon arsimi të mesëm, ndërkohë që ai ka arsimin e lartë, si dhe paga është me një diferencë të konsiderueshme në raport me atë të Specialistit të Financës apo të Edukimit.

Nga ana e përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, u theksua fakti se me të drejtë ankuesi shpreh pakënaqësi lidhur me lëvizjen e tij nga pozicioni i financierit, pasi edhe nga Kontrolli i Auditit të Brendshëm të DPB-së, është konstatuar emërimi i ankuesit jashtë kriteve arsimore në pozicionin e specialistit në Sektorin e Çështjeve Sociale në I EVP Vlorë. Sipas, përfaqësuesit të DPB-së, referuar shënimit të lënë nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, në shkresën Nr. 1684/1 prot., datë 21.02.2019, ku citohet: *“-Të merren masa sa më shpejt për tu rivendosur e drejta e ankuesit;- të fillojë menjëherë procedimi disiplinor për çdo punonjës përgjegjës...”*, do të hartohet një Memo dhe do t’i bëhet me dije Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për situatën dhe ankuesi do të rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës.

- Në vijim të procedurës hetimore për marrjen e çdo prove dhe informacioni që i shërben procesit, përfaqësuesi i DPB, shtetasi B. P., me detyrë Specialist në Drejtorinë e Çështjeve Ligjore Shoqërore dhe Shëndetësore të DPB-së, me anë të e-mailit me datë 17.04.2019, vuri në dispozicion të KMD-së, procedurën e emërimit të D. E. në I EVP Vlorë, deri në momentin e transferimit në pozicionin e Kartelistit në këtë institucion.

Në vijim të dokumentacionit të sipërcituar, përcjellë nga B. P., Drejtoria e Çështjeve Ligjore Shoqërore dhe Shëndetësore, me anë të shkresës Nr. 1684/1 prot., datë 21.02.2019, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, duke i sqaruar ankesën e paraqitur nga ana e D. E., si dhe ndër të tjera duke theksuar se: *“...D. E., është liruara nga detyra e specialistit të financës në I EVP Vlorë për t’u transferuar në detyrën e specialistit të edukimit në të njëjtin institucion në kundërshtim me ligjin. Sektori i Burimeve Njerëzore në I EVP Vlorë, duhet të kishte marrë në konsideratë rekomandimin e njësisë së auditimit në lidhje me këtë punonjës, i cili në kundërshtim me ligjin dhe kriteret arsimore është liruuar nga detyra e specialistit të financës për të cilën ka mbaruar edhe arsimin përkatës për tu emëruar në detyrën e specialistit të edukimit, vend pune ky, që kërkon arsimin për punë sociale. Po kështu ankuesi*

përveç se është liruar nga detyra për të cilën ka arsimin përkatës, nga specialist edukimi është emëruar në detyrën e kartelistit të IEVP-së Vlorë. Ky vend pune kërkon arsimin e mesëm dhe se diferenca në pagë ndërmjet këtyre dy vendeve të punës është e madhe. Sektori i Burimeve Njerëzore në IEVP Vlorë, nuk ka marrë në konsideratë rekomandimin e Njësisë së Auditimit të DPB. Po kështu burimet njerëzore në DPB, duhet të kishin trajtuar me seriozitet rastin e D. E....Nga tërësia e verprimeve të kryera në lidhje me transferimin e ankuesit nga detyra e specialistit të financës, në detyrën e specialistit të edukimit dhe më pas në atë të kartelistit, konstatohen shkelje. Lirimi dhe transferimi i D. E., është bërë në kundërshtim me Kodin e Punës së RSH. Sa më sipër dhe bazuar në konkluzionet e seancës dëgjimore të datës 20.02.2019 të KMD-së, si dhe Urdhërin Nr. 6783, datë 13.11.2017 "...për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në IEVP..." rekomandojmë që: D. E., të emërohet në detyrën e specialistit të financës në IEVP Vlorë."

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Me propozim të Drejtorit të IEVP Vlorë Nr. 46 prot., datë 12.01.2010 dhe miratuar me Urdhërin Nr. 332/2 prot., datë 18.01.2011, ankuesi është emëruar në pozicionin e Kartelistit pranë IEVP Vlorë. Duke qënë se punonjësja që mbante detyrën e specialistes së financës do të largohej nga kjo detyrë pasi përfitonte pensionin e pleqërisë dhe ky vend pune mbetej vakant, atëherë Drejtori i IEVP-së Vlorë, i ka propozuar DPB-së, emërimin e D. E. në pozicionin e specialistit të financës. Në këto kushte, me Urdhër Nr. 1568/1 prot., datë 01.03.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, D. E. është emëruar në pozicionin e specialistit të financës. Referuar propozimit me nr. 686 prot., datë 15.05.2015, të Drejtorit të IEVP-së Vlorë, DPB me urdhër të nr. 4518/1, datë 19.05.2015, ka transferuar ankuesin në pozicionin e Specialistit të Edukimit në Sektorin e Çështjeve Shoqërore. Lidhur me këtë tranferim ankuesi me anë të shkresës datë 26.05.2015, i është drejtuar Drejtorit të IEVP Vlorë, me anë të së cilës ka kundërshtuar emërimin në pozicionin e Specialistit të Edukimit, për shkak se nuk plotësonte kriterin arsimor të kërkuar për këtë pozicion pune, duke qënë se kërkohej arsimi i lartë i psikologut apo punonjësit social. Pavarësisht kundërshtimit për emërimin në këtë pozicion, nga ana e IEVP Vlorë nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare dhe ka mbajtur këtë pozicion pune deri më datë 04.11.2016, kur është transferuar me Urdhër Nr. 8465, datë 26.10.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në pozicionin e Kartelistit, në Sektorin Juridik të IEVP-së Vlorë.

Gjatë vitit 2016, IEVP Vlorë, i është nënshtruar një auditimi nga ana e Njësisë së Auditimit të Burgjeve, ku në Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për vlerësimin e veprimtarisë së IEVP Vlorë, për periudhën 01.11.2014 deri 01.06.2016”, në pikën 10, paragrafi 4, ndër të tjera është theksuar fakti se është bërë emërimi jashtë kriterëve arsimore të dy punonjësve, D. E. dhe specialistes së financës, O. M., jashtë kriterëve.

Edhe pse Njësia e Auditit të Burgjeve kishte konstatuar emërimin e specialistes së financës dhe emërimin e ankuesit në pozicionin e specialistit të edukimit, nga ana e IEVP Vlorë dhe DPB-së nuk është marrë asnjë masë, por ai është transferuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në pozicionin e kartelistit, në Sektorin Juridik të IEVP-së Vlorë, me pagë më të ulët dhe në një pozicion në të cilin kërkohet arsimi i mesëm.

Në këto kushte, ankuesi me shkresën datë 21.06.2018, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, duke e vënë në dijeni lidhur me transferimet e tij nga njëri pozicion në tjetrin dhe kërkuar që të merren masa për rikthimin e tij në detyrën e specialistit të financës. Pavarësisht kërkesës së sipërcituar, ankuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Mbështetur në Urdhërin Nr. 6783, datë 13.11.2017, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në IEVP”, konstatohet se për Pozicionin Specialist/Kartelist, në kërkesat e veçanta kërkohet Diplomë e nivelit të parë në Fakultetin e Drejtësi dhe eksperiencë pune mbi 2 vjet.

Mbështetur në informacionin e shkëmbyer gjatë shqyrtimit të një ankese⁶ tjetër të trajtuar nga KMD kundër IEVP-së Vlorë dhe DPB-së, theksohet fakti se D. E. është diplomuar në degën Ekonomi-Financë dhe ka filluar punë në këtë pozicion para miratimit të Urdhërit nr. 6783, datë 13.11.2017, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në IEVP” dhe për pasojë ky urdhër nuk ka fuqi prapavepruese.

Mbështetur në Urdhërin nr. 58, datë 24.04.2017, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës e të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”, Sektori Ligjor pranë IEVP Vlorë është i përbërë nga 1 (një) përgjegjës sektori dhe 2 (dy) specialistë. Arsimi i tre prej specialistëve është i specifikuar shprehimisht në Urdhër, ku të 2 (dy) specialistët duhet të kenë arsimim si Jurist. Në vijim të aktit të sipërpërmendur, ka dalë Urdhëri nr. 6783, datë 13.11.2017, i Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, në pikat 1 dhe 6, të së cilit përcaktohet shprehimisht, si më poshtë:

“1. Kriteret e posaçme për pozicionet e punës në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, të jenë si vijojnë:

Përgjegjës i Sektorit Diplomë e nivelit të dytë në Fakultetin e Drejtësisë.

Ligjor Eksperiencë punë mbi 5 vjet

⁶ Ankesa Nr. 71, datë 22.05.2018, e shtetases L. M.

| | |
|---|--|
| <i>Specialist/Jurist</i> | <i>Diplomë e nivelit të dytë në Fakultetin e Drejtësisë, eksperiencë punë mbi 2 vjet.</i> |
| <i>Specialist/Kartelist</i> | <i>Diplomë e nivelit të parë në Fakultetin e Drejtësisë, eksperiencë punë mbi 2 vjet;”</i> |
| <i>Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Shoqërore</i> | <i>Diplomë e nivelit të dytë në Fakultetin e Shkencave Sociale.</i> |
| <i>Specialist</i> | <i>Eksperiencë punë mbi 5 vjet</i> |
| <i>Specialist</i> | <i>Diplomë e nivelit të dytë në Fakultetin e Shkencave Sociale dega Psikologji, eksperiencë punë mbi 2 vjet;</i> |
| <i>Specialist</i> | <i>Diplomë e nivelit të dytë në Fakultetin e Shkencave Sociale/Punë Sociale, eksperiencë punë mbi 2 vjet.</i> |
| <i>Përgjegjës i Sektorit të Financës</i> | <i>Diplomë e nivelit të dytë në Degën Financë.</i> |
| <i>Specialist</i> | <i>Eksperiencë punë mbi 5 vjet</i> |
| <i>Specialist</i> | <i>Diplomë e nivelit të dytë në Degën Financë, eksperiencë punë mbi 2 vjet.”</i> |

.....

6. Të gjitha aktet nënligjore që janë në kundërshtim me këtë Urdhër, shfuqizohen.”

Sikurse vihet re, në Urdhërin nr. 6783, datë 13.11.2017, e Ministrit të Drejtësisë, është përcaktuar arsimi për 2 (dy) profile specialistësh pranë Sektorit të Çështjeve Shoqërore, të IEVP., Vlorë, të cilët kërkohet të kenë përfunduar Fakultetin e Shkencave Sociale, përkatësisht në degët Punë Sociale dhe Psikologji. Por, në referencë të parashikimit të bërë në Urdhërin nr. 58, datë 24.04.2017, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës e të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”, kjo interpretohet se vlen për 3 specialistë të këtij sektori.

Sa më sipër dhe mbështetur në informacionin e dhënë, evidentohet se pavarësisht faktit që ankuesi plotësonte kriteret e pozicionit të punës së Specialistit të Financës, nga ana e IEVP Vlorë është propozuar emërimi i tij në pozicionin e Specialistit të Edukimit, duke kërkuar kështu emërimin në një pozicion pune jashtë kriterëve arsimore. Gjithashtu, ka vijuar transferimi i ankuesit nga ana e DPB-së dhe IEVP Vlorë, në një pozicion pune jashtë kriterëve arsimore dhe me pagë më të ulët, duke e kaluar nga pozicioni i Specialistit të Edukimit, në atë të Kartelistit. Referuar informacionit të dhënë nga ana e IEVP Vlorë, këto lëvizje janë bërë duke marrë parasysh punën me orar të reduktuar për shkak të raportit të invalidit të D. E., si dhe duke zbatuar kriteret përkatëse të përshtatjes së arsimit të përfunduar me detyrën funksionale.

Referuar informacionit të dhënë nga DPB-së dhe IEVP Vlorë, nuk rezulton që ankuesi të ketë kërkuar transferimin në një pozicion tjetër pune për shkak të ngarkesës së punës, apo punëdhënësi të ketë konstatuar se ankuesi nuk mund të kryej detyrat funksionale të pozicionit në të cilin është emëruar. Në këto kushte evidentohet se ankuesi është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë e disfavorizues, duke e lëvizur nga një pozicion në tjetrin, kundër dëshirës së tij dhe në shkelje të akteve nënligjore për miratimin e kritereve të posaçme për pozicionet e punës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Pavarësisht faktit se nga KMD, është kërkuar të vihet në dispozicion të shqyrtimit të ankesës së D. E., kopje e dosjes së specialistit të financës, DPB dhe IEVP Vlorë nuk paraqitën asnjë dokumentacion apo shpjegim lidhur me këtë.

Referuar analizës së sipërcituar, shkeljet në transferimin e ankuesit nga pozicioni i Specialistit të Financës, në atë të Edukimit dhe së fundmi në atë të Kartelistit, është një fakt i konstatuar⁷ edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se ankuesi D. E. është ekspozuar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të disfavorshëm, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Vlorë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁸ të ligjit Nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Vlorë për shkak *gjendjes arsimore dhe*

⁷ Referuar shkresës nr. 1684/1 prot., datë 21.02.2019 të DPB-së.

⁸ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”

aftësisë së kufizuar, shkaqe të cilat janë parashikuar në nenin 1 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

“Gjendja arsimore dhe aftësia e kufizuar” janë shkaqe, për të cilat Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e DPB-së dhe IEVP Vlorë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkaqeve të pretenduara nga ankuesi, sipas parashikimeve të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁹ dhe trajtimit të pafavorshëm të saj.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se DPB dhe IEVP Vlorë, ishin në dijeni¹⁰ të shkeljeve në transferimin e ankuesit nga pozicioni i Specialistit të Financës, në atë të Edukimit dhe së fundmi në atë të Kartelistit.

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se transferimi dhe ulja e tij në detyrë, nuk ka ardhur si pasojë e aftësisë së kufizuar. Përkundrazi, Komisioneri ka bindjen se argumentimi i IEVP Vlorë se lëvizjet e ankuesit në pozicione të ndryshme pune dhe ulja në detyrë, janë kryer për shkak të ngarkesës voluminoze të punës, si dhe orarin e reduktuar të punës së D. E., për shkak të statusit të invalidit, ka shërbyer vetëm si justifikim.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, si dhe Kodi i Punës në ndryshimet e bëra, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organizat publik, në këtë rast DPB dhe IEVP Vlorë. Pra, në këtë rast DPB dhe IEVP Vlorë, duhet të provonin se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme.

⁹ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

¹⁰ Referuar shkresës nr. 1684/1 prot., datë 21.02.2019 të DPB-së.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”.* Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjitha organet shtetërore.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD)³, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 2012, ndalon diskriminimin ndaj kujtdo për shkak të aftësisë së kufizuar, duke marrë në konsideratë faktin që diskriminimi pengon njerëzit të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët. Konventa parashikon edhe hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, ndaluar diskriminimin de facto dhe forma diskriminuese që mund të shfaqen në të ardhmen, si dhe për të promovuar të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta me të tjerët. Ndalimi i diskriminimit, përveç se një e drejtë e veçantë, është edhe një nga parimet bazë të Konventës që udhëheq interpretimin dhe zbatimin e të drejtave të tjera të mbrojtura në të. Dispozitat e tjera shpjegojnë çfarë përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar në fushat e përkatëse, si dhe masat, përfshirë edhe ato pozitive, për të arritur barazinë në praktikë. Konventa sqaron se këto masa pozitive nuk duhet të konsiderohen si diskriminuese.

Për sa më sipër, neni 1¹¹, i Protokollit 12, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) siguron mbrojtje kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave të përcaktuara me ligj, si dhe afirmon ndalimin e diskriminimit nga ana e autoriteteve publike. Në interpretim të nenit të kësaj konvente, një person është i diskriminuar, për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 14 të KEDNJ-së, nëse nga sjellja (veprimi ose mosveprimi) i autoriteteve shtetërore, i

¹¹ Neni 1, protokollit 12 i KEDNJ parashikon shprehimisht: *“1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”*

mohohet gëzimi i të drejtave, që legjislacioni kombëtar i njeh individëve në mënyrë specifike, të cilat rrjedhin nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas legjislacionit kombëtar, nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional, si dhe nga çdo veprim ose mosveprim tjetër i një autoriteti publik¹².

Në kontekst të interpretimit të bërë nga ana e Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 6(2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, shtetet palë të kësaj konvente marrin përsipër detyrime të rëndësishme në lidhje me mosdiskriminimin dhe ruajtjen e barazisë së personave me aftësi të kufizuara. Në interpretim të Neneve 5 dhe 27, të kësaj Konvente, shtetet Palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të punuar, njësoj si pjesa tjetër e popullësisë; këtu përfshihet e drejta për të patur mundësinë për të fituar jetesën duke bërë punë të zgjedhur lirisht apo të pranuar në tregun e punës dhe vendin/ambjentin e punës që është i hapur, përfshirës dhe i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuar. Shtetet palë do të mbrojnë dhe inkurajojnë realizimin e të drejtës për punë, duke përfshirë dhe personat që e fitojnë aftësinë e kufizuar gjatë punësimit, duke marrë hapat e duhur, përfshirë masat ligjore me qëllim që ndër të tjera: të ndalojnë diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar në të gjitha çështjet lidhur me punësimin, përfshirë kushtet e pajtimit në punë, punësimit, vazhdimësisë së punësimit, ecjes në karrierë dhe ofrimin e kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës.

Në çështjen C-312/11, Komisioni Evropian kundër Republikës së Italisë, 4 Korrik 2013, GJED, është shprehur se: “...detyrimi për të marrë masa efektive dhe praktike aty ku është e nevojshme, në rastet e veçanta të përcaktuara në nenin 5 të Direktivës për Barazi në Punësim mbulon të gjithë punëdhënësit. GJED theksoi se Italia nuk kishte arritur të përmbushë detyrimin e saj për të siguruar të drejtën dhe zbatimin e plotë të nenit 5 të direktivës¹³.”

Gjithashtu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në çështjen S. U. kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, në vendimin Nr. 15, Datë 29.01.2015, është shprehur se: “... nisur nga shqyrtimi i fakteve, Komisioneri gjykon se, paligjshmëria e veprimevet e ndërmarrë nga ana e DRSSH-së Kukës në dëm të ankuesit, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, duke filluar që nga transferimi i pajustificuar i tij, në një pozicion pune i cili nuk ekzistonte, e deri në marrjen e vendimit përfundimtar të largimit nga puna duke e diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar...”

Në këtë këndvështrim, transferimet e ankuesit nga njëri pozicion në tjetrin dhe mosmarrja e masave nga ana e DPB-së dhe IEVP Vlorë, ka përballur ankuesin me një trajtim të disfavorshëm dhe të paligjshëm. Vazhdimi i kësaj situatë për vite me radhë pa ndërmarrë asnjë masë rregulluese, provon se DPB-së dhe IEVP Vlorë përmes mosveprimit, kanë

¹²Shih Sejdic dhe Finci kundër Bosnjë-Hercegovinës (2009); Savez Crkava “Rijec Zivota” dhe të tjerët kundër Kroacisë nr. 7798/08, § 58, 9 dhjetor 2010);

¹³Direktivës 2000/78/KE “Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe në marrëdhëniet gjatë punës”

neglizhuar të përmbushin detyrimet ligjore për emërimin e punonjësve sipas strukturave përkatëse.

Lidhur me sa mësipër, si dhe nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës dhe shpjegimet e dhëna nga palët, provohet fakti që ka patur një trajtim të padrejtë dhe të pafavorshëm të ankuesit.

Duhet theksuar fakti se pavarësisht detyrimit¹⁴ ligjor për t'iu përgjigjur efektivisht dhe në përputhje me ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga ana e DPB dhe IEVP Vlorë, nuk është marrë asnjë masë për t'i dhënë një përgjigje ankesave të parashtruara nga D. E.

Gjatë trajtimit të ankesës së D. E., u administruan prova dhe argumenta se ankuesi disponon shkaku e mbrojtur të aftësisë së kufizuar¹⁵. Sa i përket shkaku të gjendjes arsimore, mbështetur në provat e administruara gjatë shqyrtimit të një ankese¹⁶ tjetër të trajtuar nga KMD, kundër DPB-së dhe IEVP Vlorë, rezulton se në IEVP Vlorë, janë të punësuar jashtë kritereve arsimore dy punonjës të tjerë, shtetasit K. D. me detyrë “elektromekanik” pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe shtetasi F. F., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Shoqërore. Në këto kushte, nuk u siguruan prova për të vërtetuar se trajtimi i disfavorshëm ka ardhur si shkak i gjendjes së tij arsimore.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, me veprimet dhe mosveprimet e ndërmarra nga ana e strukturave përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Vlorë, në dëm të ankuesit, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke e vënë në pozita diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar.

Neni 3 i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka përcaktuar se: *“Diskriminim i drejtëpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.*

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1¹⁷, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se ankuesi, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e

¹⁴ Neni 13, pika 1/c, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, parashikon se: *“Punëdhënësi është i detyruar: ... c) t'iu përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre.”*

¹⁵ Mbështetur në Dëshminë e Invaliditetit Nr. 384, ankuesi vërteton faktin se është invalid i pjesshëm.

¹⁶ Ankesa Nr. 71, datë 22.05.2018, e shtetasës L. M.

¹⁷ Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Vlorë, trajtim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë, me aftësinë e kufizuar të tij.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasit D. E. nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Vlorë për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetasit D. E. nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Vlorë për shkak të gjendjes arsimore.
3. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe I.E.V.P Vlorë, për emërimin e ankuesit në pozicionin e Specialistit të Financës.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe I.E.V.P. Vlorë, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore dhe Aftësia e kufizuar)

(Fusha: Punësim)